

Vullnet Bugaqku, MA¹

UDC:
342.761
618.39-089.888.14:179.7(4)

**E DREJTA NË JETË NGA KËNDVËSHTRIMI I GJYKATËS
EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT – ANALIZË
JURIDIKE E SË DREJTËS SË ABORTIT**

**ПРАВОВОТО НА ЖИВОТ ОД АСПЕКТ НА ЕВРОПСКИОТ СУД
ЗА ЧОВЕКОВИ СЛОБОДИ И ПРАВА – ПРАВНА АНАЛИЗА
НА ПРАВОВОТО НА АБОРТ**

**THE RIGHT TO LIFE FROM THE ASPECT OF EUROPEAN
COURT OF JUSTICE ON HUMAN RIGHTS - A LEGAL
ANALYSIS OF THE RIGHT OF ABORTION**

Abstract

This paper aims to analyze, the concept of the right to life, from the perspective of the law of the European Convention on Human Rights, the jurisprudence of the European Court of Human Rights. So, I analyzed the right to life and things when life begins, how it is protected, under what conditions allowed her deprivation, and focusing in particular on the issues of abortion and the protection of the fetus within the meaning of Article 2 of the European Convention on Human Rights. A key aspect that is treated in this paper relates to the legal

¹ Autori ka mbaruar studimet e rregullta dhe ato postdiplomike ne fakultetin juridik në Universitetin e Prishtinës, “Hasan Prishtina”,-Prishtinë, në drejtimin Kushtetues-Administrativ dhe mori titullin Master i shkencave Kushtetuese-Administrative.
Email adresa: vullnet.bugaqku@gmail.com

definition of what is meant by the notion that the right to life? On this issue, the European Court of Human Rights said reserved by reference in particular leave the signatory countries according to their ability to evaluate how to establish proper legal definition of the question, What is Life? It seems that there is still no unified European compromise on determining (defining) the issue because life shows that even by the Convention namely its Article 2 not provided a legal definition of the moment when taken to base the beginning of life. The concept of the right to life is imminent right-guaranteed basic of every individual. Therefore, protection and legal regulation of this right, deserves a proper treatment through the legal regulation and serious approach that the authorities should do in order to each individual to enjoy, without restriction or interference by their actions.

The main reason that can set apart when selecting to work this paper has to do with the fact that this aroused interest and curiosity how is addressed this issue from the standpoint of the European Court of Human Rights. In other words, to what extent has reached the European Court jurisprudence on Human Rights, to give solutions to multiple situations of different dealing with most notably the fetus legal protection of the unborn (abortion) about the importance of the right to life. In particular I have studied a variety of court cases and multiple responses made by this Court, the applicants' requests that alternated between exhorting claims that this fundamental right guaranteed by Article 2 of the Convention, it was denied in many cases either consciously or improperly deliberate actions by the state authorities in general.

Key words: life, abortion, ECtHR, ECHR, pregnancy, judiciary, defense, fetus, etc.

1.KONCEPTI I SË DREJTËS NË JETË NGA KËNDVËSHTRIMI I KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, është e arritura më e madhe e Këshillit të Evropës, është nënshkruar në Romë, me datën 4 Nëntor 1950 dhe ka hyrë në fuqi në Shtator të vitit 1953.² Sipas profesoreshës së të drejtave të njeriut nga Universiteti i Prishtinës, Gjylieta Mushkolaj, qëllimi i Këshilli të

² Prof, Dr.Gjylieta Mushkolaj, "Doracak për përgaditjen e provimit të Jurisprudences", Ri-botim i vitit 2015, fq.809.

Evropës ishte që me këtë Konventë të bëhen hapat e parë për zbatimin e të drejtave të caktuara të njeriut të vendosura në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948-(DUDNJ).³

Shikuar nga aspekti analitik, Konventa ka dy dimensione juridike sipas të drejtës ndërkombëtare: Konventa njihet si marrëveshje ndërkombëtare sepse është hartuar dhe ratifikuar konform praktikës, parimeve dhe rregullave të së drejtës ndërkombëtare. Por kjo Konventë përfshin edhe dispozita që garantojnë të drejtat materiale themelore të njeriut, esencialisht i ngjan katalogut kushtetues të drejtave të njeriut.⁴ Brenda këtij katalogu kushtetues, përfshihet edhe segmenti kryesor i të drejtave të njeriut siç është e *drejta në jetë*.

Andaj mbi këtë bazë, të gjitha shtetet ratifikuese të Konventës, kanë ndjekur dhe inkorporuar në sistemin e tyre kushtetues, parimet dhe garancitë për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke iu nënshtruar kështu supremacisë së Konventës, karshi dispozitave të brendshme ligjore. Siç argumenton profesori i respektuar Benedek, të drejtat e njeriut janë universale dhe të patjetërsueshme, që do të thotë se ato aplikohen gjithandej dhe se ato nuk mund t'i mohohen individit, madje as edhe me pëlqimin e tij.⁵ Të drejtat e njeriut mbi të gjitha janë të pandashme dhe të ndërvarura. Si pikënisje e konceptit për të drejtat e njeriut është koncepti i dinjitetit të lindur dhe të patjetërsueshëm për të gjithë njerëzit, që parashikohet nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut(DUDNJ) dhe një mori traktatesh tjera ndërkombëtare, sikurse edhe ato regjionale si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁶

Sa i përket të drejtës për Jetë, nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk qartësohet parimisht se çfarë është “Jeta” ose kur dhe ku fillon dhe mbaron mbrojtja e jetës sipas nenit 2 të Konventës. Siç ka vendosur edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (këtu e tutje Gjykata) në rastin *Vo kundër Francës*⁷, apo edhe në shume raste të tjera, çështja se kur fillon e drejta për jetën, i përket hapësirës së vlerësimit që Gjykata zakonisht ka konsideruar që Shtetet duhet të

³ Po aty. fq, 809

⁴ Po aty. fq, 809.

⁵ Wolfgang Benedek, “*Kuptimi i Të Drejtave të Njeriut*”, Botues në gjuhën shqipe: Qendra për të Drejtat e Njeriut e Universitetit të Prishtinës. Botim i vitit 2009, fq.38-39

⁶ Po aty. (Vep.cit. fq. 39).

⁷ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “*Vo kundër Francës*”, vendim i dates, 8 Korrik 2004, mund të qaset në këtë

link:http://www.echr.coe.int/Documents/FS_Life_ENG.pdf

gëzojnë në këtë sferë, pavarësisht nga interpretimi i Konventës një “instrument jetik që duhet interpretohet në dritën e kushteve të sotme”.

Kjo nga fakti se problematika e tillë nuk është e zgjidhur në mënyrë konformuese nga shumica e Shteteve kontraktuese, pra duke pasur kështu një mos kompromis evropian të përkufizimit shkencor dhe ligjor të fillimit të jetës.⁸ Siç shihet nënshkruesit e Konventës, ende dhe sot e tutje nuk kanë arritur të krijojnë një standard më uniform në lidhje me rregullimin e kësaj çështje, ngase shihet që mungon një pajtim formal për ta definuar më qartë konceptin e fillimit të jetës. Kjo prerogativë, më tepër po iu adresohet vet Shteteve që ato me legjislacionin e tyre të përcaktojnë (rregullojnë) natyrën, fillimin dhe fundin e konceptit të Jetës, në kuptimin e definimit të nocionit dhe përkufizimit ligjor.

Parimisht, neni 2 parag.1 i Konventës përcakton se, jeta e njeriut mbrohet me ligj, pra termi “E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj”, paraqet kusht të domosdoshëm që autoritetet vendëse-shtetet pranuese të Konventës, obligohen që në kuadër të legjislacionit të tyre të brendshëm, të drejtën për jetë dhe shumë liri dhe të drejta të tjera që i parasheh Konventa, t’i zbatojnë në përpikëri qoftë edhe nëse është nevoja të ndërmarin masa që këto liri dhe të drejta të mbrohen me legjislacion të veçantë apo edhe direkt nëpërmjet krijimit të ligjeve adekuate, që garantojnë në mënyrë të plotë dhe pa kufizime respektimin dhe mbrojtjen e secilit individ si dhe të drejtën për jetë dhe për të jetuar.⁹ Andaj, koncepti i të drejtës në jetë, përfshinë një gamë të gjerë të vlerësimit që kryesisht fillon me nisjen e jetës, pra mbrojtjen e saj së pari në kushtet e lindjes së fetusit, mbrojtjes së tij dhe vazhdon deri në kushtet e cenimit të saj nga rrethana apo situata të ndryshme, që përfshin mbrojtjen e jetës nga ndërhyrjet apo përdorimin e forcës së tepruar të autoriteteve publike, e që për pasojë ka sjellur cenimin e jetës së njeriut. Konventa po ashtu parasheh edhe raste kur e drejta për Jetë, mund të mos mbrohet nën rrethana që të zbatohet një vendim gjykate për ndonjë dënim të shqiptuar për vdekje apo edhe nga përdorimi i forcës i bërë absolutisht i domosdoshëm.

⁸ Douwe Korff, *E drejta për Jetën*, udhëzues për zbatimin e Nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut-“*Manualet e të drejtave të njeriut*”, Nr.8,fq.10: Ky manual është i qasshëm në këtë link:

<http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/capacitybuilding/publi/materials/1057.pdf>

⁸ Korff, (vep.cit. fq. 10).

⁹ Po aty. (vep.cit.fq.10).

Pra, parag, 2 i nenit 2 të Konventës, përcakton situatat se në cilat raste Jeta nuk mirret e privuar në kundërshtim me nenin 2 të kësaj Konvente, që në përgjithësi përfshin rastet kur ofrohet mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme, për të kryer ndonjë arrestim të ligjshëm apo për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin një trazirë apo kryengritje.¹⁰ Mirëpo, jogjithherë preteksti për të përdorur forcën apo arsyetimi për ndërhyrje të shtetit në cenimin e jetës, me faktin se është nevojë absolutisht e domosdoshme, dëshmohej se ka qenë e arsyeshme, prandaj edhe kërkesat që janë trajtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga vendimet e saj, ka dhënë për të kuptuar se institucionet shtetërore sidomos ato vende të cilat janë palë nënshkruese e Konventës, jo vetëm që kanë dështuar për të ofruar mbrojtje të konceptit të Jetës për të gjithë personat por shpesh ato janë bërë vet shkelëse e këtyre parimeve thelbësore, duke pasuar kështu më sanksione dhe shumë vërejtje për shtetet të cilat kanë pasur sistem ligjor të dobët dhe mungesë kapaciteti për t'i ofruar çdokujt mbrojtjen më elementare që i duhet, pra atë të Jetës.¹¹

2.VËSHTRIM MBI ABORTIN DHE A EKZISTON E DREJTA E FETUSIT PËR MBROJTJE NGA NENI 2

Me “abort” nënkuptohet ndërprerje e shtatzënisë me dhunë, ndërsa “ndërprerje efektive e shtatzënisë” nënkuptohet ndërprerja e shtatzënisë me qëllim dhe me dëshirën e femrës pa arsye mjekësore.¹² Në Republikën e Kosovës, sipas Ligjit për Ndërprerjen e Shtatzënisë (neni 6-7) thuhet: “Ndërprerja efektive e shtatzënisë mund të bëhet deri në fund të javës së dhjetë (10) të shtatzënisë duke llogaritur nga dita e parë e ciklit të fundit menstrual. Çdo ndërprerje e shtatzënisë pas kësaj jave është në kundërshtim me ligjin dhe duhet të bëhet me komision shëndetësor profesional”.¹³ Ndërsa sipas nenit 5, 1. “Çdo

¹⁰ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (neni 2 paragrafi 2).

¹¹ Shih: Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “*Matzarakis kundër Greqisë*”, vendim i Dhomës Madhe, dt.20 Dhjetor 2004.

¹² Për më tepër: Komiteti Për të Drejtat e Fëmijës- Gjenevë, “*Raport Mbi Zbatimin e Konventës Për Të Drejtat e Fëmijës në Republikën e Kosovës*”, i publikuar në gjuhën shqipe në Nëntor të vitit 2010, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RAPORTI_PER_KDF-_nentor_2010.pdf.

¹³ Ligji Nr. 03/L-110, “*Për ndërprerjen e shtatzënisë*”, neni 6-7,

femër e moshës mbi tetëmbëdhjetë (18) vjeç ka të drejtë të kërkoj ndërprerje efektive të shtatzënisë. Femrat që kanë arritur moshën e rritur prej gjashtëmbëdhjetë (16) vjetësh dhe kanë marrë pëlqimin e prindit ose të kujdestarit ligjor kanë të drejtë të kërkojnë ndërprerjen e shtatzënisë”. Mirëpo, femrat të cilat vendosin të kenë ndërprerje të shtatzënisë janë të obliguara që së paku tri ditë para ndërprerjes së shtatzënisë të këshillohen nga specialisti përkatës.¹⁴ Ligji i tillë e përkufizon abortin si “ndërprerje e shtatzënisë me dhunë”.

Sidoqoftë, përkufizimi i abortit si akt i dhunshëm sjell një perspektivë shumë të ngushtë për shkaktarët dhe nevojat që kanë gratë kur konsiderojnë një gjë të tillë. Ligji në fjalë nuk përfshin arsyet ekonomike dhe shoqërore si arsye legjitime për të kërkuar abort përmes mjeteve mjekësore. Leja e grave nuk përmendet askund si prioritet apo çështje e rëndësishme, dhe kjo është arsyeja pse aborti në Kosovë nuk shihet nga një perspektivë e të drejtave njerëzore.¹⁵ Kurse edhe në Republikën e Shqipërisë, çështja e abortit është rregulluar me Ligjin për Ndërprerjen e shtatzënisë, *LIGJ Nr.8045, datë 7.12.1995*, i cili nuk parasheh një definicion të qartë lidhur me atë çfarë nënkuptojmë me termin “abort”, por kushtet, mënyra, rrethanat në të cilat lejohet ndërprerja e shtatzënisë, janë të përcaktuara nga dispozitat e tij.

Ndërprerja e shtatzënisë mund të bëhet për disa shkaqe e që janë: Sipas nenit 9 të këtij Ligji, “Ndërprerja e shtatzënisë për arsye mjekësore mund të bëhet deri në javën e 22 të shtatzënisë, në rast se një komision i përbërë nga 3 mjekë, pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykon se vazhdimi i shtatzënisë dhe/ose lindja e fëmijës rrezikon jetën ose shëndetin e gruas. Neni 10, “Në rastet kur gruaja vlerëson se shtatzënia i krijon probleme psikosociale, ndërprerja e vullnetshme mund të kryhet brenda javës së 12 të shtatzënisë”. Neni 11, “Ndërprerja e shtatzënisë për arsye sociale bëhet brenda javës së 22, në rast se një komision i përbërë nga 3 specialistë, mjekë, punonjës

http://msh-ks.org/ep-content/uploads/2013/11/2008_03-L-110-Ligji-per-nderprerjen-e-shtatzanise.pdf.

¹⁴ Ligji Nr. 03/L-110, “Për ndërprerjen e shtatzënisë”, Neni 5 parag.1-I qasshëm http://msh-ks.org/ep-content/uploads/2013/11/2008_03-L-110-Ligji-per-nderprerjen-e-shtatzanise.pdf

¹⁵ Shqipe Gjocaj, “Gratë në Kosovë, forca e pafuqishme riprodhuese”, më dt.18 Prill 2016, i botuar në portalin, Kallxo.com”. I qasshëm në link:<http://kallxo.com/gjnk/grate-ne-kosove-forca-e-pafuqishme-riprodhuese/>.

socialë, juristë, pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykon se shtatzënia është rezultat i përdhunimit ose një krimi tjetër seksual, si dhe kur vërtetohen arsye të tjera sociale”¹⁶

Në aspektin ndërkombëtar dhe regjional, lidhur me abortin mund të theksojmë një fakt interesant, se shteti demokratik i Kanadasë është i vetëm pa kufizime në qoftë se një grua mund të kërkojë dhe të marrë shërbime mbi abortin. Pra, Kanada është shteti në të cilin nuk ekziston legjislacioni lidhur me abortin.¹⁷ Ndërsa, vendet e tjera në Evropë, pothuajse secili shtet i rregullon me legjislacion kushtet dhe mënyrat e abortimit, p.sh. Austri-në praktikë shpesh para 12 javëve. Kushtet: Duhet të ketë konsultime mjekësore. Mund të kryhet pas 12 javësh nëse është e nevojshme për të shmangur rrezikun serioz për shëndetin fizik dhe mendor të gruas; nëse fëmija është në rrezik të lindur me një defekt të rëndë fizik ose mendor; ose në qoftë se gruaja është nën 14 vjeç. Po ashtu në të njëjtat kushte lejohet edhe në Belgjikë (12 Javë), në Bullgari (12 Javë).

Në Republikën Çeke, lejohet aborti me kërkesë të gruas deri në javën e 12 por edhe pas javës së 12-të mund të ndërpritet shtatzënia nën kushtet e njëjta sikurse edhe në vendet tjera, kur kemi rrezikim të shëndetit të gruas, kur fetusit është dëmtuar. Para se gjithash duhet patjetër të ketë një konsultim me specialistët mjekësor.¹⁸ Duke u mbështetur në dispozitat e nenit 2 të Konventës, vërejmë se nuk është parashikuar në asnjë paragraf të tij, çështja e abortit dhe nuk përfshin ndonjë të drejtë për fëmijën e palindur, më konkretisht nuk trajtohet çështja e humbjes së Fetusit.

Në rastet e ndryshme do të trajtojmë se si nëpër periudha të ndryshme, së pari nga Komisioni, e pastaj nga vet Gjykata, e kanë shtjelluar këtë çështje dhe se e drejta për jetën a nënkupton si një e drejtë që i’u takon edhe fëmijëve kushtimisht të palindur, ose duke u zhvilluar brenda Fetusit? Pyetja që mund të shtrohet po ashtu është se: a mbrohet

¹⁶ LIGJ Nr.8045, “Për ndërprerjen e Shtatzënisë”, nenet 9-11, datë 7.12.1995, I qasshëm në link.

http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/Baza_Ligjore/Ligje/8.pdf.

¹⁷ Shih: “*International Standards of Abortion Law*”, publikuar nga <https://www.weneedalaw.ca>

¹⁸ Shih: “*Europe’s Abortion Rules*”, publikuar më datë 12 Shkurt 2007, në BBC News, link. <http://news.bbc.co.uk/2/hi/6235557.stm#top>.

fetusi nga neni 2 i Konventës, në rastet kur ai në situata të ndryshme mund të humbet?

3. ZGJIDHJET LIGJORE TË OFRUARA NGA KOMISIONI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Rasti: Bruggeman dhe Scheuten k. Gjermanisë¹⁹

Ankuesit janë shtetas gjermanë që jetojnë në Hamburg. Ankuesi i parë Rose Marie Bruggemann, i lindur në vitin 1936, ankuesi i dytë Adelheid Scheuten nga Patzeld, i lindur në vitin 1939.²⁰ Kërkesa e tyre kishte të bëjë kundër ligjit penal për ndërprerjen e shtatzënisë në Republikën Federale të Gjermanisë. Ajo u zgjerua më pastaj kundër aktgjykimit të Gjykatës Federale Kushtetuese i datës 25 shkurt 1975. Gjykata Kushtetuese Gjermane, kishte vendosur se Akti i pesëmbëdhjetë i Reformës Ligjore miratuar nga Bundestagu më 26 prill 1974 (duke parashikuar dispozita me të cilat u ofrohen këshilla grave shtatzëna në lidhje me ndërprerjen e shtatzënisë) ishte i pavlefshëm, për aq sa ai e ka lejuar ndërprerjen e shtatzënisë gjatë 12 javëve të para pa kërkuar ndonjë nevojë apo arsye të veçantë.²¹

Pas vendimit të Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane, kishte hyrë në fuqi i ashtuquajtur i Ligji i pesëmbëdhjetë Penal-Akti i Reformës Ligjore, ku me ndryshimet e reja kishte përcaktuar se: “Aborti është një veprë penale por në situata të veçanta në rast shqetësimi të gruas në fjalë dhe me pëlqimin e saj, një abort i kryer pas konsultimit nga një mjek nuk është i dënueshëm”.²² Mbi këtë bazë ankuesit pretenduan se ky vendim i Gjykatës Kushtetuese Gjermane dhe akti i pesëmbëdhjetë i Reformës Ligjore, kanë ndërhyrë në mënyrë të veçantë në të drejtën e tyre private të garantuar nga neni 8 i Konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut, duke argumentuar se ata kishin të drejtën e vetme për të vendosur nëse do t’i nënshtroheshin abortit në bazë të nenit 8 të Konventës, që garanton të drejtën për respektimin e “jetës private”.²³ Mirëpo, Komisioni kishte vendosur shprehimisht se në çështjen në

¹⁹ Vendimi: “*Bruggeman dhe Scheuten kundër Gjermanisë*”, kërkesa nr.6959/75, Raporti i Komisionit i dt,12 Korrik 1977. I qasshëm në linkun: <http://www.globalhealthrights.org/ep-content/uploads/2013/10/Bruggemann-v.-Germany.pdf>

²⁰ Po aty, parag.2

²¹ Po aty, parag.3

²² “*Bruggeman dhe Scheuten kundër Gjermanisë*”, parag.4, kërkesa nr.6959/75.

²³ Po aty, parag. 5.

fjalë, “Neni 8 parag. 1 i Konventës, nuk mund të interpretohet se nënkupton që shtatzënia dhe ndërprerja e saj, janë në parim vetëm çështje të jetës private të nënës”. Nga e tërë kjo, vërejmë se ky është rast në të cilin aborti në Gjermani konsiderohej si i ligjshëm në fillim nga fakti se dispozitat ligjore në atë kohë lejonin abortimin. Sipas pretendimeve të ankuesve në fjalë, kjo është e drejtë që atyre iu takon nga ana e një ligji të mëhershëm i cili e lejonte abortimin pa marrë parasysh rrethanat ose konsultimet me ndonjë mjek. Mirëpo, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, ligji si i tillë kishte pësuar ndryshime dhe më pastaj e drejta e abortimit ishte e lejuar por konform situatës së pranueshme ligjore, me kusht që të ketë dhënë pëlqimin gruaja në fjalë dhe të konstatohej nga një mjek kompetent nëse mbajtja e fetusit të tillë i shkaktonte gruas dëmtimin e shëndetit ose cenimin e jetës.

Pra, aborti i kryer pa këto dy kushte, konsiderohej si vepër penale sipas Gjykatës Kushtetuese Gjermane, por nëse ekzistonin rrethana që bartja e fetusit e dëmton shëndetin e gruas dhe pas konsultave nga mjeku, aborti mund të bëhej dhe nuk mirret si i dënueshëm. Duke i qëndruar kështu parimisht zgjidhjes që kishte ofruar Gjykata Kushtetuese Gjermane, Komisioni konstatoi se zgjidhjet ligjore që u parashikuan me Aktin e Reformës Ligjore nuk mund të thuhet që shpërfillin aspektin e jetës private lidhur me problemin e abortit. Vendimi i Gjykatës Federale Kushtetuese i dt./ 25 shkurt 1975, jo vetëm që njohu indikacionet mjekësore, eugjenike dhe etike, por gjithashtu deklaroi se kur shtatzënia ndërpritet nga një mjek me pëlqimin e gruas shtatzënë brenda 12 javëve të para dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mjekun, atëherë në këtë rast aborti i tillë nuk mund të trajtohet si i dënueshëm.²⁴ Duke konstatuar se në rastin konkret nuk ka patur ndërhyrje në konceptin e jetës private të garantuar nga neni 8 parag.1 i Konventës.

Rasti: X kundër Mbretërisë së Bashkuar²⁵

Komisioni duke e analizuar situatat e rastit, kishte konstatuar atë që u theksua më lartë se neni 2 nuk e parasheh apo nuk përmend abortin. Në situatë të tillë, ky nen nuk e përfshin abortin në kuadër të veprave

²⁴ Parag. 62, i vendimit: “*Bruggeman dhe Scheuten kundër Gjermanisë*”, kërkesa nr.6959/75, Raporti i Komisionit i dt.12 Korrik 1977.

²⁵ Rasti: “*X kundër Mbretërisë së Bashkuar*”, Kërkesa Nr. 8416/79, Vendimi mbi Pranueshmërinë i 13 majit 1980. Për më tepër shih analizën e D. Korff, *E drejta për Jetën*, udhëzues për zbatimin e Nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut- “*Manualet e të drejtave të njeriut*”, Nr.8, fq.10-11

që nuk konsiderohen se bie në kundërshtim me këtë nen.²⁶ Sipas Komisionit, kjo nënkuptonte që kishte vetëm tri mundësi; ose që neni 2 nuk e mbulon fare fetusin e palindur, ose që njeh të drejtën për jetën e fetusit me disa kufizime të nënkuptuara, apo i jep të drejtë absolute fetusit për të jetuar.

Komisioni hapur përjashtoi interpretimin e fundit, sepse nuk lejonte që të merrej në konsideratë ndonjë rrezik që mund të lindë për jetën e nënës. Kjo nga fakti se do të nënkuptonte që ‘jeta e palindur’ e fetusit do të konsiderohet se është e një vlere më të lartë sesa jeta e gruas shtatzënë”. Ky nuk mund të jetë interpretimi i duhur i Nenit 2 në lidhje me abortin, sepse jo gati të gjitha Palët Kontraktuese të Konventës e lejonin abortin kur ai ishte i nevojshëm për të shpëtuar jetën e nënës, edhe që nga viti 1950 kur u hartua Konventa, por në të njëjtën kohë kishte pasur nëse mund të thuhet “një tendencë drejt liberalizimit të mëtejshëm [të abortit]”.²⁷ Të gjitha kufizimet e mësipërme nga natyra e tyre, kanë të bëjnë me persona që kanë lindur tashmë dhe që nuk gjejnë zbatim për fetusin. Kështu, si përdorimi i përgjithshëm i termit “çdokush” (“toute personne”) në Konventë, edhe konteksti në të cilin përdoret ky term në Nenin 2, tentojnë të mbështesin pikëpamjen se ai nuk e përfshin fëmijën e palindur.²⁸ Këtu gjatë trajtimit të rasteve që Komisioni ishte përballur rreth çështjes së lejimit apo jo të abortit, mund të vërehet se ka pasur dilemën e tij nga fakti se a parashihet aborti në kuadër të nenit 2 të Konventës, si një mundësi që gëzon mbrojtje ligjore.

Duket se kishte rezerva për ta trajtuar abortin në kuptimin e mbrojtjes ligjore sepse fetusin ende i palindur nuk merrej si një person që i njihej ekzistenca e tij si qenie njerëzore. Konventa dhe neni 2 i saj pothuajse nuk e mbronin juridikisht fetusin e palindur. Qasja e Komisionit në trajtimin e këtij rasti, mund të them se më shumë anohet nga pikëpamja që çështjen e fetusit të palindur e interpretonte në kuptimin që neni 2 i Konventës nuk e mbulonte fare. Mirëpo, duhet theksuar se më vonë kishte raste që e njihte të drejtën e fetusit me disa kufizime të nënkuptuara. P.sh. në çështjen *H kundër Norvegjisë*²⁹, Komisioni pak a

²⁶ Korff, (vep.cit, fq. 10-11) .

²⁷ Po aty. ”*X kundër Mbretërisë së Bashkuar*”, Kërkesa Nr. 8416/79, Vendimi mbi Pranueshmërinë i 13 majit 1980.

²⁸ Korff, (vep.cit, f. 10-11) .

²⁹ Rasti: “*H kundër Norvegjisë*”, nr.17004/90, Vendim i Komisionit, 19 Maj 1992, DR 73, f.155.

shumë shkoi më tej në drejtim të zgjedhjes së dytë, duke mos përfshirë se në rrethana të caktuara, fetusi mund të ketë apo të gëzojë një mbrojtje të caktuar nga neni 2 fjalë e parë pavarësisht dallimeve apo divergjencave që shtetet nënshkruese i kishin në pikëpamje se deri në çfarë shkalle, neni 2 i Konventës e mbron fëmijën e palindur.³⁰

4. ZGJIDHJET E OFRUARA NGA GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Rasti: Bosso kundër Italisë³¹

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dha një vendim për një kërkesë që kishte direkt lidhje me abortin. Rasti kishte të bënte me një grua që kishte abortuar kundër dëshirës së babait të mundshëm të fëmijës (Bosso, bashkëshort i saj) por që ishte në përputhje me të drejtën përkatëse vendëse përkatësisht me Ligjin nr.194 i vitit 1978 për abortin në Itali. Gjykata konstatoi se nuk i kërkohet të përcaktojë nëse fetusi mund të kualifikohet për mbrojtje nën fjalinë e parë të Nenit 2 të Konventës edhe pse duke supozuar se në rrethana të caktuara, fetusi mund të konsiderohet se ka të drejta që mbrohen nga neni 2 i Konventës.³² Nga ky rast mund të theksojmë se Gjykata, kishte ndjekur një qasje maksimaliste sa i përket të drejtës së abortit në raport me nenin 2 të Konventës. Këtu nuk vërehet ndonjë dallim nga vendimet e mëhershme të trajtuara nga ana e Komisionit.

Gjykata e mori në trajtim çështjen Bosso dhe argumentoi që aborti i tillë i kryer nën kushtet e lejuara nga legjislacioni vendës nuk cenon nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kështu ajo i kushtoi vëmendje dispozitave të brendshme ligjore lidhur me përcaktimin e kushteve në lejimin e abortit, pra, vjen në pah se kur kemi situatën e kërcënimit të jetës ose shëndetit fizik ose mendor të gruas, aborti i tillë është i lejueshëm. Gjykata Evropiane për të drejtat e Njeriut (GJEDNJ), vëren se në këtë çështje, megjithëse kërkuesi nuk deklaroi numrin e javëve që kishin kaluar përpara abortit apo motivet e sakta mbi të cilat ishte kryer, duket nga provat se shtatzënia e gruas së tij ishte ndërprerë në përputhje me pjesën 5 të Ligjit nr.194 të vitit 1978.³³ Mbi

³⁰ Po aty, “*H kundër Norvegjisë*”.

³¹ Rasti: “*Bosso kundër Italisë*”, vendim për pranueshmëri, nr.50490/99,i dt.5 shtator 2002.

³² Rasti, “*Bosso kundër Italisë*”, i trajtuar nga Korff, (vep.cit.f.14)

³³ Korff, (vep.cit. f.14).

këtë bazë, Gjykata sqaroi se legjislacioni përkatës Italian, autorizon abortin brenda dymbëdhjetë javëve të një shtatzënie nëse ekziston rrezik për shëndetin fizik dhe mendor të gruas, ose kur është përcaktuar se fëmija do të lindë në kushte të rënda të tilla, sa të rrezikojnë shëndetin fizik ose mendor të gruas. Aty vijohet se aborti mund të kryhet për të mbrojtur shëndetin e gruas. Sipas mendimit të Gjykatës, dispozita të tilla vendosin një ekuilibër të barabartë midis nevojës për të siguruar mbrojtjen e fetusit dhe nga ana tjetër interesat e gruas.

Pra, duke pasur parasysh kushtet e kërkuara për ndërprerjen e shtatzënisë dhe për rrethanat e rastit, Gjykata nuk konstatoi se shteti i paditur në këtë çështje Italia ka shkuar përtej hapësirës së tij të veprimit në një fushë të tillë delikate.³⁴ Andaj sipas kësaj pikëpamje të Gjykatës, kërkesa për abort të fëmijës mund ti lejohet nënës vetëm për raste kushtimisht kërcënuese për jetën dhe shëndetin e saj, si në aspektin fizik ashtu edhe mendor.

Sipas interpretimit të tillë, çështja e lejimit të abortit në raste të tilla pikë së pari duhet të jetë çështje e rregulluar me legjislacionin të brendshëm të një shteti dhe më pastaj varet nga konstatimi mjekësor nëse gjendja shëndetësore e nënës që bartë fetusin i shkakton rrezik permanent për jetën dhe shëndetin fizik të saj.³⁵ Pra, është qartë se si nga ana e Komisionit e po ashtu edhe tani nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, aborti duket se është i lejuar mirëpo gjithnjë duke i ndjekur kushtet dhe mundësit ligjore të përcaktuara nga legjislacionet vendëse. Me një fjalë, sipas Gjykatës në këtë rast, shteti i Italisë nuk ka përgjegjësi për mos parandalimin e abortit të tillë, nga fakti se ligji nr.194 i vitit 1978, e parashikonte lejimin e abortit brenda dymbëdhjetë javëve të një shtatzënie, përveç nëse “kishte rrezik për shëndetin fizik dhe mendor të gruas, ose në situatën kur është përcaktuar se fëmija do të lindë në kushte të rënda sa që do e rrezikonte shëndetin dhe jetën e nënës”.

Vërejmë se, si Komisioni më herët edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në vendimet e tyre rreth çështjes së abortit, mbajtën qëndrim rezervë sa i përket dilemës nëse fetusi i pa lindur mund të gëzojë mbrojtje ligjore nga ana e nënit 2 fjalë e parë e Konventës. Në çështjen Bosso, megjithatë Gjykata ka një qasje më progresive duke nënkuptuar në mënyrë indirekte se fetusi mund të gëzojë mbrojtje ligjore nga ana e

³⁴ Korff, (vep.cit. f.15)

³⁵ Konkluzionet e rastit, “*Bosso kundër Italisë*”.

nenit 2 të Konventës pra, lejon abortin por nën kushtet e përcaktuara nga ligjet përkatëse të shteteve anëtare të Konventës.

Rasti: Vo kundër Francës³⁶

Në këtë rast, kërkuesja ishte një grua shtatzënë që kishte për qëllim të çonte deri fund shtatzëninë e saj, për të cilën mendohej se fëmija do të lindte normal apo të paktën me shëndet të mirë. Megjithatë gjatë një vizite që ajo pati në spital, atë e ngatërruan me një grua tjetër që kishte emër të ngjashëm dhe i vunë një spirale në uterus që shkaktoi derdhjen e lëngut amniotik dhe si rezultat i kësaj, ajo iu nënshtrua një aborti terapeutik që çoi në vdekjen e fetusit. Zonja Vo, pretendoi se mjekët kishin vepruar pa kujdes dhe se ata duhet të ndiqeshin penalisht, ligjërisht me akuzën për vrasje të pa qëllimshme. Shtrohej pyetja nëse dispozitat e të drejtës penale franceze që zbatohen në rastin e një gabimi mjekësor i cili si pasojë pati “ndërprerjen e padëshiruar të shtatzënisë, ishin në përputhje me kërkesat e Konventës?” Gjykata në këtë rast, duhet të shprehej nëse ndërprerja e shtatzënisë e detyruar nga rrethanat, mund të analizohet si një cenim i së drejtës për jetë të fetusit.

Gjykata, duke iu përgjigjur kësaj pyetje, bëri një analogji me rastet e mëhershme të vendosura nga precedenti i Komisionit, në çështjet *X kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *H kundër Norvegjisë dhe çështjes Bosso kundër Italisë* dhe përfundoi se: “Duke u bazuar nga këndvështrimi i precedentëve të mëhershëm, se në rrethanat e shqyrtuara deri atëherë nga institucionet e Konventës d.m.th, në ligjet e ndryshme mbi abortin, fëmija i pa lindur nuk konsiderohet si “person” që drejtpërdrejtë mbrohet nga neni 2 i Konventës dhe nëse fëmija i palindur ka në fakt një të drejtë për “jetën”, ajo kufizohet në mënyrë të nënkuptuar nga të drejtat dhe interesat e nënës”.³⁷ Pra, gjykata refuzoi të vendosë duke vlerësuar se përcaktimi i fillimit të jetës duke pasur parasysh ndryshimin e koncepteve dhe kulturave juridike që mbizotërojnë në Evropë, mbetet nën hapësirën e vlerësimit të Shteteve të cilën ajo e cilëson si “pushtet të gjerë të pakufizuar”.³⁸ Nga e tërë kjo, mund të përfundojmë

³⁶ Rasti: “*Vo kundër Francës*”, vendim i datës, 8 Korrik 2004. Link: <http://hudoc.echr.coe.int/eng/?i=001-61887>

³⁷ Po aty: “*Vo kundër Francës*”. vendim i datës, 8 Korrik 2004.

³⁸ Jean-Francois Akandji-Kombe, “*Detyrimet Pozitive sipas Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut*”, udhëzues për zbatimin e Neni 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut-“*Manualet e të drejtave të njeriut*”, Nr.7, f.2122. Këshilli i Evropës, 2002. Botimi i parë, 2003.

se fetusit në gjendjen e sotme të së drejtës, nuk mund të konsiderohet sipas Konventës si një person juridik i mbrojtur dhe për të cilin Shteti do të duhej të merrte përsipër detyrime. Fati i fetusit, kryekëput lidhet me vullnetin e nënës dhe e drejta për cenimin e tij në situata të tilla siç proklamohet Gjykata, i lihet vetëm nën autoritetin e nënës dhe përgjegjësisë së shtetit që me legjislacion të garantojë jetën e çdo individi që jeton dhe frymon nën juridiksionin e tij. Këtu gjykata, me një fjalë është shprehur e rezervuar të komentojë më tepër përgjegjësinë e shtetit, karshi mbrojtjes së fetusit kushtimisht ende të palindur.

5. ZGJIDHJET E OFRUARA NGA PERSPEKTIVA E GJYKATËS KUSHTETUESE FEDERALE NË GJERMANI

Mirëpo duhet theksuar se, ndryshe nga qëndrimet e mëhershme të mbajtura si nga ana e Komisionit e pastaj edhe të Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut, Gjykata Kushtetuese Gjermane në rastin e njohur si *BVerfGE 39, 1* (Schwangerschaftsabbruch I) (Aborti), pothuajse ka proklamuar qasje krejtësisht ndryshe nga jurisprudenca e tillë e këtyre institucioneve. Shikuar nga këndvështrimi i Gjykatës Kushtetuese gjermane, fëmija i cili është në fazën e zhvillimit të sipër gëzon tashmë mbrojtje ligjore e shtetërore nga pikëpamja e nenit 2 paragrafi 2 të Kushtetutës Gjermane dhe se baza ligjore e ofruar në atë kohë për ndryshimin e ligjit të Pestë për reformën penale, ishte shpallur si në kundërshtim me Kushtetutën sepse ai ligj i njohur si akti i pestë i reformës ligjore kishte paraparë mundësinë e ndërprerjes së shtatzënisë apo mbyttjes së fetusit pa pasur ndonjë arsytim të nevojshëm.³⁹

Gjykata kushtetuese Gjermane kishte vënë detyrim të pastër Shtetit, se ka obligime konform kushtetutës për ti ofruar mbrojtje ligjore fetusit që gjendet në zhvillim e sipër, duke argumentuar qëndrimin e saj se "detyra e Shtetit për mbrojtjen e fetusit, jo vetëm që e ndalon ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të shtetit në zhvillimin e jetës së fëmijës por

³⁹ Rasti: *BVerfGE 39,1* (Schwangerschaftsabbruch I), i botuar në përmbledhjen e Prof. Dr. Jürgen Schwabe, "Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale në Gjermani", Botim Jubilar i realizuar në kuadër të Programit të Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore të mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer Stiftung, botim i V-2010, fq.128-131. Mund të qaset në linkun. http://www.kas.de/ef/doc/kas_22457-1522-1-30.pdf?110411104408

edhe i kërkon shtetit për të mbrojtur dhe për të nxitur atë (fetusin).⁴⁰ Detyra e shtetit për të mbrojtur jetën e fëmijës në zhvillim vlen edhe si kundër nënës. Në parim, mbrojtja e jetës së embrionit gëzon prioritet mbi të drejtën e gruas shtatzënë për të vetëvendosur gjatë periudhës së shtatzënisë dhe nuk mund të konsiderohet si subjekt i përjashtimit gjatë një periudhe të caktuar.⁴¹

Pika thelbësore është se tërësia e masave të hartuara për të mbrojtur fëmijën e palindur në fakt siguron një shkallë të mbrojtjes e cila korrespondon me rëndësinë e interesit për t'u mbrojtur. Në një rast ekstrem, ku mbrojtja e kërkuar me Kushtetutë nuk mund të arrihet në ndonjë mënyrë tjetër, ligjvënësi është i detyruar për të bërë përdorimin e ligjit penal me qëllim mbrojtjen e jetës së fëmijës në zhvillim.⁴² Një grua nuk mund ta ketë te nevojshme vazhdimin e shtatzënisë së saj në qoftë se ndërprerja e saj është e nevojshme për të shmangur një rrezik për jetën e saj apo të lëndimit të rëndë në shëndetin e saj”.⁴³

Pra, nga ky qëndrim i Gjykatës Kushtetuese Gjermane, vërejmë se pavarësisht që konceptimi i jurisprudencës evropiane shprehet i rezervuar për të përcaktuar nëse gëzon apo jo mbrojtje fetusi ende i palindur në kuptimin ligjor karshi nenit 2 të Konventës, Gjykata Kushtetuese Gjermane nuk u rezervua dhe dha një vendim që i përket karakterit progresiv evolutiv, duke përcaktuar-vendosur mbi të gjitha se e drejta për Jetë që e proklamoi neni 2 paragrafi 2 i Kushtetutës Gjermane, siguron mbrojtjen e jetës për të gjithë personat madje edhe për ata që konsiderohen në zhvillim e sipër në barkun e nënës.

Conclusion

While doing some research on a case from the European Court over Human Rights that had Abortion as a debating subject, I noticed that within the article number 2 of ECHR the unborn child can't be considered protect by this article. This happens because the European Convention of Human Rights doesn't foresee the legal regulation of abortion on the article 2, this for the reason that as mentioned the Court, when interpreted known cases, H vs Norway and Bosso vs Italy. The European Convention of Human Rights does not foresee the legal regulation of abortion on article 2. So, article number 2 does not treat

⁴⁰ Rasti: BVerfGE 39,1, (Schwangerschaftsabbruch I), paragrafi 1, fjalia e dytë.

⁴¹ Po aty, BVerfGE 39,1 (Schwangerschaftsabbruch I), paragrafi 3.

⁴² Po aty, paragrafi 4

⁴³ Po aty, paragrafi 5

the fetus as a protect subject from the Convention and especially here the Court is declared reserved by defining that the fetus can't be considered a legal protected person and that the State should be taking responsibilities for. The fate of the fetus was directly related with the mother's desire and that the right to its violation is attributed to States with adequate legislation to determine the conditions and ways of abortion as well as the protection of the unborn child positive obligation and responsibility for the Government and specifically in the context of Article 2 of the Covention. Federal Constitutional Court of Germany on the case known as: " BVerfGE 39,1"(Shwangerschaftsabbruch), had declared the opposite of what the European Court proclaimed. According to the interpretation of the Constitutional Court of Germany, the Government's duty on protecting the fetus not onlu stops the Government's direct interference in the development of the child's life but it requires to stimulate and protect it.

Moreover, ascertaining that this is a right guaranteed by the German Constitution and that the unborn child should have protection and the fetus's fate can't always be depended on the mother's desire. The German Constitutional Court ruled that abortion can be allowed and it won't be punished as a penal act as long as the legal conditions are met which includes a consult with a doctor as well and that is ascertained that keeping the fetus threatens the mother's life, otherwise in Germany is considered a penal act and is punishable. Under these conditions, we can say that the majority of European countries allow abortion with certain limitations and restrictions from the inner laws which usually determine until the 12 weel of pregnancy and in some countries even further, but it's essential to have medical consults.

Literatura

1. Douwe Korff, *E drejta për Jetën*”, udhëzues për zbatimin e Nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut-“*Manualet e të drejtave të njeriut*”.
2. Gjylieta Mushkolaj, ” *Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës*”, Ri-botim i vitit 2015,
3. Jean-Francois Akandji-Kombe, “*Detyrimet Pozitive sipas Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut*”, udhëzues për zbatimin e Nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut-“*Manualet e të drejtave të njeriut*”,Nr.7, Këshilli i Evropës, 2002. Botimi i parë: 2003.

4. 6. Jeffrey Jowell dhe Jonathan Cooper, *"Të Kuptuarit e Parimeve mbi të Drejtat e Njeriut"*, botuar nga Hart Publishing, Oxford dhe Portland, Oregon, Viti 2001.

5. 7. Wolfgang Benedek, *"Kuptimi i Të Drejtave të Njeriut"*, botues në gjuhën shqipe: Qendra për të Drejtat e Njeriut e Universitetit të Prishtinës. Botim i vitit 2009.

Dokumente:

6. *"Konventa Evropiane Për Të Drejtat e Njeriut"*, Romë, 4 Nëntor, 1950, ndryshuar me Protokollet nr.11 dhe 14 shoqëruar nga Protokollet Nr.1, 4, 6, 7, 12 e 13.

7. *"Kushtetuta e Republikës së Kosovës"*, 15 Qershor 2008.

8. Ligji Nr. 03/L-110, *"Për Ndërprerjen e Shtatzënisë"*, në Republikën e Kosovës.

9. Ligji, Nr.8045, "Për Ndërprerjen e Shtatzënisë", në Republikën e Shqipërisë.

10. Prof. Dr. Jürgen Schwabe, *"Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale në Gjermani"*, Botim Jubilar i realizuar në kuadër të Programit të Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore të mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer Stiftung, botim i V-2010

11. Komiteti Për të Drejtat e Fëmijës- Gjenevë, *"Raport Mbi Zbatimin e Konventës Për Të Drejtat e Fëmijës në Republikën e Kosovës"*, i publikuar në gjuhën shqipe në Nëntor të vitit 2010

Vendime gjyqësore të Komisionit për të Drejtat e Njeriut:

12. Vendimi: *"Bruggeman dhe Scheuten kundër Gjermanisë"*, kërkesa nr.6959/75, Raporti i Komisionit i dt, 12 Korrik 1977.

13. Vendimi: *"X kundër Mbretërisë së Bashkuar"*, Kërkesa Nr. 8416/79, Vendimi mbi Pranueshmërinë i 13 majit 1980.

14. *"H kundër Norvegjisë"*, nr.17004/90, vendim i Komisionit, 19 Maj 1992

15. Vendime gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

16. *"Bosso kundër Italisë"*, vendim për pranueshmëri nr. 50490/99, i dt.5 shtator 2002.

17. *"Vo kundër Francës"*, vendim i datës 8 Korrik 2004.

18. *"Matzarakis kundër Greqisë"*, vendim i Dhomës Madhe, dt.20 Dhjetor 2004.

19. Vendime gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese Federale në Gjermani:

20. “*Bruggeman dhe Scheuten kundër Gjermanisë*”, kërkesa nr.6959/75,Raporti i Komisionit i dt,12 Korrik 1977.

21. *BVerfGE 39,1* (Schwangerschaftsabbruch, I dhe II,)

Burime elektronike:

22. http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf.

23. <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-115539>.

24. <http://kallxo.com/gjnk/grate-ne-kosove-forca-e-pafuqishme-riprodhuese/>.

25. http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/Baza_Ligjore/Ligje/8.pdf.

26. “*International Standards of Abortion Law*”, <https://www.weneedalaw.ca>.

27. “*Europe’s Abortion Rules*”. <http://news.bbc.co.uk/2/hi/6235557.stm#top>.

28. <http://www.globalhealthrights.org/ep-content/uploads/2013/10/Bruggemann-v.-Germany.pdf>

29. http://www.kas.de/ef/doc/kas_22457-1522-1-30.pdf?110411104408.